



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE

MONITORIMI I SHPENZIMEVE PËR PROGRAMIN “EMERGJENCAT CIVILE ”

PËR 12-MUJORIN E VITIT 2023

Monitorimi i zbatimit të buxhetit të 12-mujorit të vitit 2023 për programin buxhetor “*Emergjencat Civile*” përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Strukturat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave, kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar në përputhje me planin strategjik të ecurisë së institucionit dhe të gjitha kërkesave ligjore.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi, evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të “*Emergjencave Civile*” në krahasim me planin e miratuar, të detajuar në nivel treguesi performance. Analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor i mundëson institucioneve orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Me qëllim për të kontribuar në proceset bazë të misionit dhe objektivave të institucionit buxheti i “*Emergjencave Civile*”, do të mbështetet plotësisht në udhëzimet standarde të hartimit të buxhetit mbi bazë të treguesve të performancës, por gjithashtu dhe monitorimin e realizimit buxhetor mbështetur mbi ato tregues të planifikuar gjatë hartimi të programit buxhetor afatmesëm. Ky raport zyrtar do të shërbejë si një pasqyrë e rëndësishme përmes së cilës AKMC dhe DPRMSH do të synojnë lidhjen e kostove buxhetore me produktet e performancës, si forma më e mirë e buxhetimit dhe vlerësimit financiar të ecurisë së institucionit.

❖ KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË PERFORMANCËS

Programi buxhetor “*Emergjencat Civile*” administron dhe menaxhon fondet publike, sipas dy njësive shpenzuese të miratuara, konkretisht:

- 1) Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)
- 2) Rezervat e Shtetit (DPRMSH)

Buxheti vjetor fillestar për Programin “*Emergjencat Civile*” është **4 560 300 mijë lekë**, buxhet i cili në zbatim të akteve normative të dala gjatë 12-mujorit ka pësuar ndryshime, duke pakësuar në vlerën **140 776 mijë lekë**, nga ku rezulton se për vitin 2023 buxheti me ndryshime i programit të jetë në vlerën **4 419 524 mijë lekë**.

Realizimi i periudhës, për buxhetin e ndryshuar, paraqitet në vlerën **1 737 907 mijë lekë**.

Fondet e miratuara për vitin 2023 për këtë program përbëjnë rreth 11.4% të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shpenzohen për realizimin e objektivave.

Objektivi 1: Zvogëlimi e humbjeve në jetë njerëzish, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe në mjedis.

Tregues performance:

- Nderhyrje te ofruara ne rast termeti
- Nderhyrje te ofruara ne rast permbytje
- Nderhyrje te ofruara ne rast zjarri


Objektivi 2 : "Rritja e stokut ne mallra ushqimore e industriale dhe krijimi i kushteve optimale për miradministrimin e mallrave të konsideruara si rezervë shtetërore"

Tregues performance:

- Rritja e stokut të mallrave rezervë shteti të cilat do të përdoren për t'i ardhur në ndihmë familjeve të prekur nga fatkeqësitë natyrore me mallra rezervë shtetërore.


Në sistemin e thesarit SIFQ fondi për investime të huaja në vlerën **1 900 000** mijë lekë nuk është çelur asnjëherë (aktivizuar nga MFE si fond i ngrire) dhe për rrjedhojë realizimi i tij për vitin 2023 paraqitet në masën 0%.

Gjatë 8- muorit të vitit 2023, burimet financiare janë përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligj.




Sikurse vihet re edhe nga grafiku, peshëm në të madhe të buxhetit total e zenë investimet kapitale të huaja, mosrealizimi i të cilave ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e performaces se programit.

Realizim buxheti "Emergjencat Civile" viti 2023



Buxheti dhe realizimi "Emergjencat Civile" viti 2023



Treguesit bazë të realizimit buxhetor për këtë program paraqiten si më poshtë:

Tabela Nr.1
lekë

Në 000

Ministria e Mbrojtjes									
Programi	10910						Kodi		
Emergjencat Civile									
				Totali Shpenzimeve					
Artikulli	Emri	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(4)-(6) Diferenca	Perqindja kundrejt 12-mujorit (6/5*100)
		Fakti i vitit paraardhes Viti 2022	PBA Viti 2023	Buxheti Vjetor Plani fillestar Viti 2023	Buxheti Vjetor Plani i Rishikuar Viti 2023	Buxheti/ Plani i 12-M-2023	Fakti i 12-M-2023		
Kodi									
600	Paga	114,104	164,000	164,000	237,920	237,920	224,475	13,445	94.3
601	Sigurime Shoqërore	19,051	27,000	27,000	25,800	25,800	25,305	495	98.1
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	209,363	306,000	306,000	276,100	276,100	257,286	18,814	93.2
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	0	#DIV/0!
604	Transferta Korente të Brendshme	439,309	800,000	800,000	799,000	799,000	509,793	289,207	63.8
605	Transferta Korente të Huaja	3,070	4,000	4,000	33,900	33,900	33,816	84	99.8
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,490	0	0	3,504	3,504	575	2,930	16.4
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	787,386	1,301,000	1,301,000	1,376,224	1,376,224	1,051,250	324,974	76.4
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	#DIV/0!
231	Kapitale të Trupëzuara	505,875	1,359,300	1,359,300	1,143,300	1,143,300	686,657	456,643	60.1
Nen -Totali	Shpenz. Kap. me financ. Brendshem	505,875	1,359,300	1,359,300	1,143,300	1,143,300	686,657	456,643	60.1
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	#DIV/0!
231	Kapitale të Trupëzuara	0	1,900,000	1,900,000	1,900,000	1,900,000	0	1,900,000	-
Nen -Totali	Shpenz. Kap. me financ. të huaj	0	1,900,000	1,900,000	1,900,000	1,900,000	0	1,900,000	#DIV/0!
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale Brend+Huaja	505,875	3,259,300	3,259,300	3,043,300	3,043,300	686,657	2,356,643	22.6
Nen-Totali	Shpenzime Korrente+Kapitale	1,293,261	4,560,300	4,560,300	4,419,524	4,419,524	1,737,907	2,681,617	39.3
Shpenzime nga te ardhurat jashte limitit									#DIV/0!
Totali (korrente + kapit.+ shp.nga te ardh. j. lim.)		1,293,261	4,560,300	4,560,300	4,419,524	4,419,524	1,737,907	2,681,617	39.3

Për programin “*Emergjencat Civile*”, janë planifikuar 4 produkte në zërat “*Shpenzime Korente*” me vlerë 1 376 224 mijë lekë dhe 10 projekte investimi i në zërin “*Shpenzime Kapitale te brendshme*” me vlerë 1 143 300 mijë lekë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve, për 12- mujorin e vitit 2023 në këtë program buxhetor , rezulton si më poshtë:

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korente	76.4 %
Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve kapitale	22.6 %
Gjithsej	39.3 %

Vlen të theksohet se:

Gjatë vitit 2023, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, në llogarinë ekonomike 604 “**Transferta korrente të brendshme**” ka realizuar transferimin e 800 000 mijë lekë në të gjitha bashkitë e vendit, me shkresën e MFE nr 6937/1 datë 28.04.2022 “*Dërgohet miratimi për rishpërndarjen e fondit për emergjencat civile për vitin 2023*”, në përputhje me kërkesat e ushëzimit plotësues nr 2 datë 19.01.2023 “*Për zbatimin e buxhetit viti 2023*”. Këto fonde edhe pse kanë kaluar dhe administrohen nga bashkitë përkatëse, në Sistemin Informatik Financiar Qeveritar (SIFQ) janë të lidhura me programin “*Emergjencat Civile*” dhe realizimi i këtij fondi, paraqitet në vlerën 509 793 mijë lekë ose 63.8 %.

Në llogarinë ekonomike 231 “Shpenzime kapitale të brendshme”, specifikisht në projektin me kod **18AZ901** “Fatkeqësi Natyrore të Menaxhuara”.

* Njësia shpenzuese, AKMC nga Fondi total 1 200 000 mijë lekë “Fatkeqësi natyrore të menaxhuara”, në zbatim të ligjit të buxhetit 84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023” u ka transferuar Bashkive, fondet si me poshte:

- Me shkresën e MFE nr 4233/1 Prot. datë 04.04.2023 “Miratim limiti”, në vlerën 110 881 mijë lekë për financimin e investimeve në disa bashki të vendit,
- Me shkresën e MFE nr 9022/1 Prot. datë 12.06.2023 “Miratim limiti”, në vlerën 874 691 mijë lekë për financimin e investimeve në disa bashki të vendit,

Gjithashtu edhe këto fonde të transferuara në Sistemin Informatik Financiar Qeveritar (SIFQ) janë të lidhura me programin “Emergjencat Civile”. Në total buxheti i transferuar me ndryshime për Bashkite paraqitet në vlerën 950 925 mijë lekë dhe realizimi i këtij fondi paraqitet në 621 016 mijë lekë.

Në zbatim të vendimit nr 834 dt 28.12.2023 “Për një ndryshim të Vendimit nr. 929 datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë”, të ndryshuar dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa Institucione”, në fund të vitit 2023 nga AKMC janë transferuar, për shpërblimin e strukturave zjarrfikëse, 82 820 mijë lekë nga llogaria ekonomike 600 në strukturat e vetëqeverisjes vendore. Sikurse edhe me transfertat e tjera, realizimi i këtij fondi nga ana e bashkive lidhet me programin “Emergjencat Civile”, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në performancën e këtij programi.

Gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2023 lidhur me problematikat e hasura nga bashkitë, AKMC ka ngritur urdhrin nr. 236 staë 22.09.2023 “Për ngritjen e komisionit të kontrollit të mënyrës së përdorimit të fondit të kushtëzuar dhe investimeve pranë institucioneve të pushtetit vendor”. Ky komision gjatë takimeve në teren evidentoi se, shumica e bashkive edhe pse i kishin aktive në llogaritë e tyre fondet në llogarinë ekonomike 604 “Transferta korrente të brendshme” nuk kishin marrë masa për alokimin dhe përdorimin e tyre sipas nevojave, në përputhje me VKM nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile” e ndryshuar me VKM-në nr. 290 datë 17.05.2023. Problematikë tjetër e e hasur në zbatueshmërinë e këryre VKM-ve është dhe fakti se këto VKM legjitimojnë përdorimin e fondeve për kompenisimin e shtetasve të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore si dhe për realizimin e blerjeve të mallrave, shërbimeve dhe mjeteve në fushën e Mbrojtjes Civile brenda kornizave të cituara në to. Duke marrë në konsideratë gjithë bazën ligjore mbi të cilën funksionon sistemi buxhetor në Republikën e Shqipërisë përkatësisht Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Neni 1, pika b, citohet se klasifikimi ekonomik përfaqëson klasifikimin e transaksioneve sipas natyrës ekonomike, pra degët e thesarit nuk miratojnë përdorimin e fondeve në llogarinë ekonomike 604 për blerjen e mallrave dhe shërbimeve (llogaria ekonomike 602) dhe mjete (llogaria ekonomike 231). Sa më sipër kjo problematikë kërkon ndryshimin e Ministrisë së Financave për kapërcimin e këtij ngërçi ligjor.

Lidhur me zbatueshmërinë e VKM-së 260 datë 27.04.2023 “Për miratimin e projekteve fituese të financuara nga fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, si dhe Autoritetit Kontraktitor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të Vetëqeverisjes Vendore” shumica e praktikave të bashkive në muajt e fundit të vitit ishin në proces prokurimi cka përkethehet në vonesë në zbatueshmërinë e projekteve, mos realizim i likuidimeve dhe për rrjedhojë performancë e ulët e AKMC-së dhe domosdoshmëri e financimit të këtyre projekteve për vitin pasardhës.

Analitikisht tabela e projekteve të investimeve të brendshme të programit, paraqitet si më poshtë vijon:

Kodi i projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Realizimi progresiv nga fillimi i projektit deri në përfundim 12-Mujori viti 2022	Buxheti i kontraktuar viti 2023	Plani i buxhetit viti 2023 12--mujori	Realizimi progresiv nga 12-mujori viti 2023	Realizimi per periudhen e raportimit 8-mujori 2023	Realizimi progresiv nga fillimi i projektit deri në përfundim 12-Mujori viti 2023	Komente
18AZ901	Masa parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese në disa bashki të vendit	3,408,524	2022	2026	382,009	1,200,000	988,000	634,817	634,817	634,817	Ky projekt është në vazhdim
MI70411	Bashkefinancim, TVSH dhe taksa doganore	67,547	2021	2026	0	10,000	10,000	6,374	6,374	6,374	Ky projekt është në vazhdim
20AD102	Blerje software për përmirësimin e sistemit të paralizimit të hershem	182,500	2023	2024	0	61,800	61,800	-	0	0	Është në proces prokurimi nga AKSHI
20AD103	Aplikimi i sistemeve të informacionit gjeografik (GIS) dhe Web GIS	28,800	2023	2024	0	18,000	18,000	-	0	0	Është në proces prokurimi nga AKSHI
20AD104	Blerje software baza e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë	18,300	2023	2024	0	8,300	8,300	-	0	0	Është në proces prokurimi nga AKSHI
20AD105	Blerje sistem për video konferenca	1,200	2023	2023	0	1,200	1,200	-	0	0	Është pasqyruar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve për vitin 2023, aktualisht nuk ka filluar si procedurë.
22AG101	Bashkefinancim me projektet e huaja	39,667	2023	2024	0	20,000	20,000	29,617	29,617	29,617	Ky projekt është në vazhdim
MI70521	Blerje mallra rezerve shteti ushqimore	250,000	2014	Deri në plotësim të limitit minimal	156,000	24,000	24,000	13,979	13,979	13,979	Ky projekt është realizuar në masën 74% si pasojë e dështimit të procedurës së prokurimit për disa lloje (mungesë oferte të vlefshme) Ky projekt konsiderohet pjesërisht i realizuar
MI70528	Blerje mallra rezerve shteti industrial	70,000	2018	Deri në plotësim të limitit minimal		14,000	14,000				Ky projekt rezultoi i pa realizuar për vitin 2023. Arsyeja është shpallja me vonë e fituesit. Për këtë arsye DPRMSh do të vijojë realizimin e këtij projekti vitin në vazhdim bazuar në marrëveshjen kuadër e dhjetorit 2023
21AD301	Blerje ushqim për bageti	7,000	2022	2026	1,951	2,000	2,000	1,869	1,869	1,869	Ky projekt është realizuar në masën 93%. Pjesa e mbetur pa shpenzuar është kursim nga investimi. Ky produkt është totalisht i realizuar.
		4,073,538			539,960	1,359,300	1,147,300	686,657	686,657	686,657	

Statusi i realizimit të këtyre projekteve është në 60.1% kundrejt 12 mujorit të vitit 2023. nëse nuk do të merret në konsideratë “Financimi i Huaj” kapitull 02 në vlerën 1.900.000 mijë lekë. Nëse kalkulimet do të bëhen me vlerën e sipërpërmendur atëherë realizimi bëhet në mënyrë drastike në vlerën 22.6%

❖ **Buxheti për Programin Emergjencat Civile ka ndryshuar si më poshtë:**

NDRYSHIMET NË BUXHET

Në zbatim të Udhëzimit të MFE Nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” si dhe akteve normative të dala në vazhdim, ndryshimet e buxhetit për 12-mujorin e vitit 2023 paraqiten si më poshtë vijon :

Shtesa

- 600 73 920 mijë lekë
- 606 3 504 mijë lekë

Pakësime

- 231 200,000 mijë lekë (Shkresa e MF nr 19139/47 datë 02.11.2023 në zbatim te AN. 5 datë 18.10.2023)
- 604 1,000 mijë lekë (Shkresa e MF nr 22656/75 datë 28.12.2023 në zbatim te AN. 6 datë 14.12.2023)
- 231 16.000 mijë lekë (Shkresa e MF nr 22656/75 datë 28.12.2023 në zbatim te AN. 6 datë 14.12.2023)

INFORMACION MBI DETYRIMET E PRAPAMBETURA

Detyrimet e prapambetura për periudhën Janar-Dhjetor 2023, nga njësia shpenzuese AKMC janë në vlerën **354 296 mijë lekë**.

Detyrime fillestare të mbartura nga viti 2022, ishin **529 269 mijë** leke. Gjatë vitit 2023 nga rishikimi i dosjeve nga Sektori I Investimeve Infrastrukturore dhe Kompesimit të Qytetarëve, me anë të shkresës nr. 1288/1 Prot. datë 19.12.2023, janë regjistruar shtesa 66 418 mijë lekë dhe pakësime 187 961 mijë lekë. Me shkresën nr. 145 Prot. datë 18.01.2024 nga ana e Sektorit të Çështjeve Ligjore është bërë interpretimi dhe saktësimi i vendimit të Gjykatës lidhur me detyrimin e AKMC-së kundrejt Viva Helicopters dhe është pakësuar detyrimi i njohur në vlerën 54 430 mijë lek. Për rrjedhoj detyrimi i njohur dhe rakorduar për vitin 2023 është 354 296 mijë lekë,

- ✚ ***Si konkluzion, në total realizimi i buxhetit për 12 mujorin e vitit 2023 për programin buxhetor “Emergjencat Civile” është në masën 39.3%. Rreth 43% të buxhetit total të programit e zënë investimet e huaja, vlerë e cila nuk është e celur në SIFQ dhe për rrjedhoje realizimin e ka 0%. Nëse kjo vlerë nuk do të përfshihej në monitorim realizimin i programit buxhetor “Emergjencat Civile” do të ishte në masën 69%.***
- ✚ ***Element tjetër i rëndësishëm me impakt në performancë është përdorimi i fondeve të AKMC-së ne llogaritë ekonomike 600, 604 dhe 231 nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, mos realizimi/realizimi i të cilave është përtej kompetencave ekzekutuese të drejtëpërdrejta të AKMC-së .***

Në bazë të vlerësimit të të dhënave të realizimit të shpenzimeve buxhetore gjatë çdo muaji, është ndjekur sistematikisht dhe me përgjegjësi menaxhimi i fondeve buxhetore .

Problematikat e konstatuara gjatë këtij viti do të jenë objekt i vëmendjes dhe trajtimit me qëllim shmangien e përsëritjes së tyre në vijim.